



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 112, datë, 09.07.2020

“MBI

**MIRATIMIN E “RREGULLORES PËR PROFILET E STANDARTIZUARA TË
NGARKESËS PËR KATEGORI TË CAKTUARA KLIENTËSH, NË RAST SE TË
DHËNAT E MATJEVE, TË NEVOJSHME PËR LLOGARITJEN E DISBALANCEVE,
NUK JANË TË DISPONUESHME”**

Në mbështetje të neneve 16; 69, gërma f; 86, pika 6 të Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, neneve 15 dhe 26 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e bordit të ERE nr.96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E) në mbledhjen e tij të datës 09.07.2020, mbasi shqyrtoi relacionin, nr.78/6 datë 29.06.2020 të hartuar nga Drejtoritë Teknike në lidhje me miratimin e “Rregullores për profilet e standartizuara të ngarkesës për kategori të caktuara klientësh, në rast se të dhënat e matjeve, të nevojshme për llogaritjen e disbalanceve, nuk janë të disponueshme”,

Konstatoi se:

- ERE me Vendimin nr. 202, date 12.12.2019, ka filluar procedurën për shqyrtimin dhe miratimin e “Rregullores për profilet e standardizuara të ngarkesës për kategori të caktuara klientësh, në rast se të dhënat e matjeve, të nevojshme për llogaritjen e disbalanceve, nuk janë të disponueshme”.
- Pas marrjes së Vendimit për fillimin e procedurës ERE me shkresën me nr.32/57, datë 16.12.2019 njoftoi në median e shkruar palët e interesuara si dhe me shkresën nr.850 prot, datë 13.12.2019 palët e interesit për të shprehur komentet dhe sugjerimet e tyre lidhur me këtë draft rregullore.
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) me shkresën me nr. 525/6, datë 24.12.2019, u shpreh parimisht dakord mbi propozimet e Shoqërisë "OSHEE" sha, por kërkoi që kjo rregullore të hyjë në fuqi brenda një afati me të arsyeshëm, të vlerësuar nga ERE, në përputhje me detyrimet ligjore dhe nënligjore të sektorit të energjisë elektrike, si dhe angazhimit sipas Direktivave të Bashkimit Evropian.
- Shoqata Shqipëtare e Furnizuesve të Energjisë Elektrike (AEES) me shkresën me nr. 35, datë 13.01.2020 propozon që:

- Në nenin 11 të rregullores të shtohen dy pika si më poshtë:
 1. *Në rast se OSSH nuk paraqet për miratim në ERE "Profilet fillestare të standardizuara të ngarkesës", brënda një afati 30 ditor nga data e fundit në të cilën përcaktohet detyrimi i OSSH për t'i dërguar në ERE për miratim, këto profile hartohen dhe miratohen nga ERE, dhe i dërgohen OSSH dhe OST për zbatim.*
 2. *Në rast se OSSH nuk paraqet për miratim në ERE përditësimin e "Profileve të standardizuara të ngarkesës", profilet aktuale në fuqi do të aplikohen automatikisht edhe në vitin pasardhës.*
- Neni 13 i Rregullores që lidhet me "Hyrjen në fuqi të rregullores" të riformulohet si më poshtë:
 - *Këto rregulla do të hyjnë në fuqi pas miratimit nga Bordi i ERE.*
 - Komenti i tretë lidhet me kapacitetin teknik të OST për të përlogaritur disbalancat në përputhje me përcaktimin e pikës 6, të nenit 8, të "Rregullave të përkohëshme për mekanizmin balancues të energjisë elektrike", Në rast se OST nuk e ka akoma kapacitetin për t'i përlogaritur disbalancat nëpërmjet softit të menaxhimit të sistemit elektroenergjitik, ERE mund të përcaktojë në "Rregullore" një afat, bazuar në të cilin disbalancat do të përlogariten automatikisht nga sistemi dhe jo manualisht
- Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, me shkresën me nr.21/7, datë 16.01.2020, shprehu dakortësinë e ndër të tjera propozoi që:
 - *Duke marrë në konsideratë vonesën në implementimin e PSN (Profileve standarte të ngarkesës), hyrja në fuqi e tyre duhet të jetë menjëherë me marrjen e Vendimit nga bordi i ERE-s.*
 - *OSSH të përcaktojë PSN për kategori të ndryshme klientësh jo më vonë se tetori 2020.*
 - *ERE të përcaktojë që PSN të jenë të aplikueshme për klientët dhe furnizuesit nga 1 Janari 2021.*
- Pas marrjes së këtyre komenteve, ERE me shkresën me nr.126, datë 22.01.2020, njoftoi zhvillimin e një séance dëgjimore, me përfaqësues të OSSH, OST, MIE, AK, Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë, Shoqatës për Mbrojtjen e Konsumatorit, Shoqatës së Konsumatorit Shqiptar, Shoqatës Konsumatori në Fokus, Zyrës për Mbrojtjen e Konsumatorit.
- Në seancën dëgjimore të datës 28.01.2020 morrën pjesë përfaqësues të OSSH sha, OST sha, Autoritetit të Konkurrencës (AK), AEES dhe Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë.
- OSSH sha në séancë bëri me dije se i qëndronte edhe njëherë problematikave të saj të shprehura edhe procedurës së shqyrtimit të kësaj rregulloreje, por pavarësisht kësaj OSSH sha u shpreh që, brenda datës 20.02.2020 do të paraqiste në ERE, një draft përfundimtar të rregullores për profilet e standartizuara të ngarkesës ku do të reflektonte komentet dhe sugjerimet përfundimtare të saj.
- OST për këtë rast u shpreh që, për arsye sigurie nuk mund të lejojë aksesin në bazën e saj të të dhënave, ndërkohë që në zbatim të planit të rimëkëmbjes së sektorit të Energjisë elektrike,

duhet të krijohet një bazë e veçantë të dhënash ku mund të aksesojë OSSH sha, dhe deri në atë moment të dhënat do të jepen vetëm nga OST nëpërmjet tabelave për sa i përket kategorisë së klientëve në nivel tensioni 35kV.

- AK u shpreh parimisht dakort me draft rregulloren por duke sugjeruar hyrjen e saj në fuqi në një kohë sa më të shpejtë, duke patur në konsideratë vonesat e deritanishme në propozimin dhe miratimin e saj dhe për të mos penguar më tej, daljen në treg të lirë të klientëve të energjisë elektrike.
 - AEES shprehu serisht në séancë qëndrimin e mbajtur më herët me shkresën me nr. 35, datë 13.01.2020, duke theksuar edhe njëherë domosdoshmërinë e miratimit në një kohë sa më të shpejtë dhe hyrjen në fuqi të rregullores në mënyrë që të mos ketë më pengesa për klientët fundorë që duan të dalin në treg të lirë, si edhe për furnizuesit potencialë për përzgjedhjen e klientëve të tyre.
 - Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë, shprehu shqetësimin e saj për vonesën e propozimit të këtij akti nga ana e OSSH sha, duke e konsideruar si pengesë për bizneset në fushën e energjisë (siç janë Furnizuesit) por edhe për klientët fundorë në ushtrimin e së drejtës së tyre ligjore për daljen në treg të lirë.
 - Draft rregullorja u dërgua nga OSSH sha, me shkresën nr. 1944 prot., datë 17.03.2020, prot duke integruar në rregullore dhe metodologjinë e hartimit të profileve standarte të ngarkesës.
 - Procedura e hapur nga ERE me Vendimin nr.202, date 12.12.2019, në zbatim të sa parashikuar në legjislacionin në fuqi, ka për qëllim vetëm miratimin e “Rregullores për profilet e standardizuara të ngarkesës” dhe jo të metodologjisë së përgatitjes së këtyre profileve të standartizuara të ngarkesës e cila është në kompetencën dhe diskrecionin e OSSH
 - Duke patur në konsideratë korrespondencat dhe komentet e sipërpërmendura nga grupi i punës u përpunua draft rregullorja në vijim duke marrë në konsideratë dhe duke integruar në rregullore:
 - Propozimet e AEES për ndryshime në nenin 11 të rregullores ku shtohet pika si më poshtë:

OSSH duhet të hartojë dhe të publikojë "Profilet e standardizuara të ngarkesës", brenda një afati 4 muor nga hyrja në fuqi e kësaj Rregullore. Në çdo rast tjetër tjetër profilet e standartizuara të ngarkesës do të hartohen dhe publikohen sipas përcaktimeve të pikave 4 dhe 5 të nenit 8 të rregullores
 - Propozimet e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë dhe AEES në lidhje me ndryshime në nenin 14 të Rregullores që parashikon hyrjen në fuqi të saj si më poshtë:

Rregullorja hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletore Zyrtare.
 - Propozimet e OSSH lidhur me kategoritë e klientëve për të cilët do të hartohen profilet e standartizuara.

Neni 9 “Kategoritë e klienteve” u ndryshua si më poshtë:
1. OSSH duhet të përgatisë profile të standartizuara të ngarkesës për kategoritë bazë të identifikuar (privat, buxhetorë, jo-buxhetore familjare) sipas nivele të tensionit.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Miratimin e “Rregullores për profilet e standartizuara të ngarkesës për kategori të caktuara klientësh, në rast se të dhënat e matjeve, të nevojshme për llogaritjen e disbalancave, nuk janë të disponueshme”.(Bashkëlidhur)
2. OSSH sh.a. nëpërmjet akteve të brendshëm të përcaktojë modalitetet teknike për hartimin e profileve të standartizuara të ngarkesës.
3. Profilet Standarte të Ngarkesës të hartuar sipas kësaj rregullore bëhen të aplikueshme për klientët dhe furnizuesit nga 1 janari 2021.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletore Zyrtare.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brënda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brënda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Petrit AHMETI



ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

**RREGULLORE PËR PROFILET E STANDARTIZUARA TË NGARKESËS PËR
KATEGORI TË CAKTUARA KLIENTËSH, NË RAST SE TË DHËNAT E
MATJEVE, TË NEVOJSHME PËR LLOGARITJEN E DISBALANCEVE, NUK
JANË TË DISPONUESHME**

Miratuar me Vendimin e bordit të ERE nr. 112, datë 09.07.2020.

**Neni 1
Baza Ligjore**

Kjo Rregullore hartohet në mbështetje të neneve 69, gërma f dhe 86, pika 6, te Ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar.

**Neni 2
Qëllimi**

Kjo rregullore siguron zbatimin e përcaktimeve të pikës (6) të nenit 86 dhe gërmës (f) të nenit 69 të Ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe aplikohen në përputhje me detyrimet e Traktatit të komunitetit të energjisë, që të mundësojnë hapjen e tregut me pakicë të energjisë elektrike në vëndin tonë, në rastet kur klientët kërkojnë të ndryshojnë furnizuesin e energjisë elektrike.

**Neni 3
Fusha e zbatimit**

1. Kjo Rregullore vendos:

- i. Kriteret për përcaktimin e profileve standarte të ngarkesës që aplikohen për çdo kategori Klientësh Fundor për të cilët matja e konsumit real në intervale kohore nuk është e disponueshme.
- ii. Kriteret sipas të cilave Operatori i sistemit të shpërndarjes duhet të hartojë dhe implementojë profilet e standardizuara të ngarkesës që do të përdoren për kategori te caktuara klientesh në rast se të dhënat e matjeve, të nevojshme për llogaritjen e disbalanceve, nuk janë të disponueshme.
- iii. Kriteret në bazë të cilave Operatori i sistemit të shpërndarjes ushtron aktivitetin e tij në lidhje me përmbushjen e kushteve teknike për klientët në mënyrë që ata të jenë të aftë të ndryshojnë furnizuesin e tyre në treg të liberalizuar.



ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

2. Kjo rregullore përcakton marrëdhënien midis Operatorit të sistemit të shpërndarjes, dhe furnizuesve të cilët furnizojnë Klientin fundor, disbalancat e të cilëve do të llogariten sipas një profili të standartizuar të ngarkesës.

Neni 4

Perkufizimet

1. Termat e përdorur, por që nuk përcaktohen në këte rregullore kanë kuptimin që është dhënë për këto terma në Ligjin Nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar.
2. **Profili ngarkesës:** paraqet diagramën e ndryshimit të ngarkesës elektrike shprehur në njësinë W (Watt) kundrejt një intervali kohe të përcaktuar.
3. **Profilet e konsumit reale apo të standartizuara të ngarkesës:** paraqesin konsumin e energjisë elektrike në intervale kohore të barabarte me intervalin kohor të llogaritjes së disbalancave.
4. **Intervali kohor i llogaritjes së disbalancave:** është njësia kohore sipas së cilës disbalancat e palëve përgjegjëse për balancim llogariten. Ky interval kohor përcaktohet në Rregullat e balancimit të energjisë elektrike.
5. **Profili i konsumit real:** është konsumi faktik i energjisë elektrike, sipas treguësve të sistemit të matjes të instaluar në pikën e matjes së energjisë elektrike për klientin.
6. **Profili i standartizuar i ngarkesës:** është një profil konsumi i përgatitur nga Operatori i sistemit të shpërndarjes për kategori të caktuara të klientësh në rast se të dhënat e matjeve të nevojshme për llogaritjen e disbalancave, nuk janë të disponueshme. Profili i standartizuar i ngarkesës do të hartohet për një interval kohor të njëjtë me intervalin kohor të llogaritjes së disbalancave.
7. **Operatori i sistemit të shpërndarjes:** është Operatori i sistemit të shpërndarjes (OSSH) sh.a.
8. **Furnizues i mundësisë së fundit (FMF):** është një furnizues i caktuar në përputhje me ligjin për sektorin e energjisë elektrike, i cili ofron për një periudhë të kufizuar kohe shërbimin e furnizimit në kushte të rregulluara ndaj klientëve, të cilët nuk kanë mundur të kontraktojnë vetë një furnizues ose kanë humbur furnizuesin e tyre

Neni 5

Vlerësimi i Kritereve dhe kushteve teknike të sistemeve të matjes

1. Sipas Nenit 86, pika 6, Operatori i sistemit të shpërndarjes duhet të vlerësojë nëse sistemi i matjes i klientit që furnizohet nga Furnizuesi i mundësisë së fundit përmbush kushtet teknike për ta lejuar klientin të furnizohet në treg të liberalizuar.
2. Operatori i sistemit të shpërndarjes do të vlerësojë kushtet teknike të sistemit të matjes, pa cënuar të drejtën e klientëve për të përzgjedhur furnizuesin e energjisë elektrike.

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË**

3. Operatori i sistemit të shpërndarjes duhet të garantojë aksesin në rrjetin e shpërndarjes sipas përcaktimeve ligjore në fuqi për klientët që kanë përzgjedhur furnizuesin e energjisë elektrike përpara lidhjes me rrjetin e shpërndarjes.
4. Operatori i sistemit të shpërndarjes do të vlerësojë kriteret e mëposhteme, për të përcaktuar nëse klienti mund të furnizohet me energji elektrike në tregun e liberalizuar.
 - a. Klienti është një Klient fundor me sistem matje të regjistruar në Operatorin e sistemit të shpërndarjes me adresë pikën në të cilën klienti konsumon energjinë elektrike.
 - b. Klienti furnizohet dhe faturohet për konsumin e tij të energjisë elektrike bazuar në vlerat e matura të cilat lexohen nga sistemi matës, përfshirë dhe nëse janë të aplikueshme, korrigjime periodike të mëvonshme.
 - c. Operatori i sistemit të shpërndarjes ka akses në sistemin e matjes për të siguruar lexim periodik të matësit të energjisë elektrike.
5. Vlerësimi i kushteve teknike siç është përcaktuar në pikën 6 të nenin 86 të ligjit 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, do të bazohet në kriteret e paragrafit 3 të këtij Neni.
6. Sistemi inteligjent i matjes është i preferueshëm, por nuk është para-kusht për një klient i cili ndryshon furnizuesin dhe nuk përbën një kriter për Operatorin e sistemit të shpërndarjes për të konfirmuar aftësinë e klientit për t’u furnizuar nëpërmjet një furnizuesi në treg të liberalizuar.

Neni 6**Të drejtat dhe detyrimet e klientëve**

1. Të gjithë Klientet fundorë kanë të drejtë të ndryshojnë Furnizuesin e tyre pa pagesë.
2. Klienti brenda 5 ditëve nga kërkesa e bërë duhet të informohet nga OSSH sh.a., lidhur me rezultatin e vlerësimit të kriterëve të përcaktuara në nenin 5 pika 3, me qëllim furnizimin me energji elektrike në tregun e pa rregulluar
3. Në rastin kur klienti nuk i përmbush kriteret e përcaktuara në nenin 5, pika 3 të kësaj rregullore, Operatori i sistemit të shpërndarjes do të informojë klientin mbi informacionin që duhet të plotësojë për përmbushjen e kriterëve. Pas plotësimit të kriterëve klienti mund të ushtrojë të drejtën ligjore për përzgjedhjen e furnizuesit të energjisë elektrike. Në të gjitha rastet e tjera, konsiderohet se klientët i përmbushin kushtet për të ndryshuar furnizuesin pa kushte të tjera.
4. Informimi sipas paragrafit 3 të këtij neni duhet të përfshijë çdo informacion të veçantë që klienti duhet të ofrojë me qëllim për të lehtësuar procesin e përmbushjes së kushteve të përcaktuara në nenin 5 pika 3.



ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Neni 7

Profilet e standardizuara të ngarkesës

1. Operatori i sistemit të shpërndarjes do të krijojë profile të standardizuara të ngarkesës për të gjitha kategoritë e klientëve në rastin kur të dhënat e kërkuara të matjes për llogaritjen/shlyerjen e disbalancave nuk janë në dispozicion nga sistemi i matjes i klientit.
2. Nëse periudha e vendosur për llogaritjen e disbalancave është çdo orë, profili i standartizuar i ngarkesës duhet të jetë të paktën në intervale një orëshe. Në çdo rast profili i standartizuar i ngarkesës duhet të përcaktohet sa periudha kohore e përcaktuar për llogaritjen e disbalancave e vendosur në Rregullat e balancimit të energjisë elektrike në fuqi.
3. Profilet e standartizuara të ngarkesës zëvendësojnë profilet e konsumit real për palën përgjegjëse për balancimin sipas Rregullave të balancimit të energjisë elektrike për llogaritjen/shlyerjen e disbalancave, për çdo periudhë gjatë të cilës matja e cila mat konsumin faktik në interval kohore nuk është e disponueshme.

Neni 8

Krijimi i profileve të standardizuara të ngarkesës

1. Operatori i sistemit të shpërndarjes duhet të hartojë profile të standardizuara të ngarkesës bazuar në dy kritere të përgjithshme:
 - a. Kategorinë e klientëve
 - b. Zonën Administrative ku është i lidhur klienti.
2. Klientet të cilët i përkasin një kategorie kanë të njëjtat karakteristika dhe për llogaritjen/shlyerjen e disbalancave, konsumi i energjisë elektrike për këto standartizohet për një profil ngarkese të veçantë.
3. Për disa kategori klientesh operatori i sistemit të shpërndarjes mund të marrë në konsideratë dhe kriterin e zonës administrative ku është lidhur klienti.
4. Profili i Standardizuar i ngarkesës për çdo kategori klientësh do të hartohet nga operatori i sistemit të shpërndarjes për një periudhë prej të paktën një vit kalendarik.
5. Profili i Standardizuar i ngarkesës për çdo kategori klientësh për çdo vit kalendarik do të publikohen në faqen e internetit të OSSH sh.a. të paktën tre muaj para fillimit të vitit në të cilin këto Profile të standartizuara të ngarkesës do të aplikohen..
6. Para publikimit të profileve të standartizuara të ngarkesës, Operatori i sistemit të shpërndarjes mund të konsultohet me pjesëmarrësit e tregut, ERE dhe palët e tjera të interesuara.
7. Gjatë aplikimit të tyre Operatori i sistemit të shpërndarjes periodikisht mund të rishikojë profilet e standartizuara të ngarkesës për vitin kalendarik në mënyrë që profilet të standartizuara të ngarkesës të jenë sa më afër profileve reale të ngarkesës.



ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Neni 9

Kategoritë e klientëve

1. Operatori i sistemit të shpërndarjes duhet të hartojë profile të standartizuara të ngarkesës për kategoritë bazë të klientevë të identifikuar: (i) privat, (ii) buxhetore, (iii) jo-buxhetore, (iv) familjare.

Neni 10

Forma e profileve

1. Profilet e ngarkesës duhet të përgatiten në formë tabelash ku të përfshihet numri i orëve gjatë ditës dhe raportet korresponduese të cilat tregojnë marrëdhënien midis konsumit gjatë asaj ore dhe konsumin ditor.

Neni 11

Afatet kohore

1. Profilet e standardizuara të ngarkesës për të gjitha kategoritë e klientëve fundorë që janë të lidhur në rrjetin e Operatorit të sistemit të shpërndarjes dhe të specifikuar në këto rregullore duhet të hartohen dhe të publikohen nga operatori i sistemit të shpërndarjes, i bëhen me dije në çdo rast ERE.
2. Operatori i sistemit të shpërndarjes do të krijojë një bazë të dhënash nga matësat të cilët realizojnë matje me interval kohore (matsat inteligjent), si dhe nga pajisje të tjera të përshtatshme matëse të cilat lejojnë grumbullimin e të dhënave që kanë lidhje me profilet reale të ngarkesës për të gjitha kategoritë e klientëve.
3. Bazuar në të dhënat e mbledhura Operatori i sistemit të shpërndarjes duhet të përditesojë profilet e standartizuara të ngarkesës në mënyrë periodike dhe të paktën një herë në vit.
4. Operatori i sistemit të shpërndarjes duhet të synojë që nëpërmjet përditesimit të profileve të standartizuara të ngarkesës të minimizojë për aq sa është e mundur disbalancat për këtë kategori klientësh.
5. Operatori i sistemit të shpërndarjes duhet të hartojë dhe të publikojë profilet e para të standardizuara të ngarkesës, sipas kesaj rregulloreje brënda njëafati 4 mujor nga hyrja në fuqi e rregullores. Në çdo rast tjetër profilet e standartizuara të ngarkesës do të hartohen dhe publikohen sipas përcaktimeve të pikave 4 dhe 5 të nenit 8 të rregullores.
6. Në çdo rast rishikimi të profileve të standartizuara të ngarkesës operatori i sistemit të shpërndarjes duhet ti publikojë sipas afateve të parashikuara në këtë nen.



ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Neni 12

Aksesi i të dhënave të matjes

1. Operatori i sistemit të shpërndarjes duhet të ketë akses në sistemin e matjes për të siguruar lexim periodik të matësve të Klientëve fundorë të lidhur në rrjetin e saj, por të furnizuar nga Furnizuesit.
2. Operatori i sistemit të transmetimit (OST sh.a.) duhet të ofrojë akses në të dhënat e matësve të klientëve që ajo administron sipas Nenit 3, pika 3.4 e marrëveshjes dy palëshe midis OST dhe operatori i sistemit të shpërndarjes datë .28.12.2017.

Neni 13

Rishikimi dhe Ndryshimi i Rregullores

Kjo Rregullore është objekt rishikimi dhe ndryshimi me vendim të Bordit.

Hyrja në fuqi

Neni 14

Kjo rregullore hyn në fuqi, pas botimit të vendimit në Fletoren zyrtare.